



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Shoqata Radio Maria (OJQ)  
Nr. i regjistrimit: 5102515-6  
Greta KAÇINARI  
Drejtoreshë  
Radio Maria  
Objekti Katana  
Obiliq

Ref: 1711/1306/LIC/ni

**VENDIM**

*për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Maria, me seli në Obiliq*

**Fakte**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Maria është Ofrues Medial Audio me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në shërbim të qytetarëve të Komunës së Obiliqit.
3. Më 29 shtator 2017, Radio Maria ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së lokacionit të sistemit të transmetimit nga objekti Katana në Obiliq, për ku janë të licencuar për të transmetuar, duke e zhvendosur sistemin e transmetimit në objektin në fshatin Shkabaj, Komuna e Obiliqit.
4. Arsyetimi i pronarit të Radio Maria, për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, bazohet në ndërprerje të shpeshta të energjisë elektike dhe problemeve me shërbimet e internetit, përfshirë edhe koston e lartë të qirasë në vendndodhjen aktuale të sistemit të transmetimit.
5. Më datë 17 tetor 2017, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) i KPM-së ka realizuar matjet teknike në piken e propozuar për vendosjen e transmetuesit të Radio Maria në lokacionin në fshatin Shkabaj, Komuna e Obiliqit, me lartësi mbidetare 596m, për të vlerësuar gjendjen faktike në terren si dhe ka bërë analizën e rezultateve lidhur me ndryshimin e lokacionit të transmetimit, sipas kërkesës së Radio Maria.

**Arsyetim**

6. Neni 16 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 1 thekson se: *Përveç dispozitave për bartjen e pronësisë të specifikuar në Nenin 15, i*

1 / 2

*Licencuari paraprakisht parashtron kërkesë me shkrim për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Rrezatuar Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pasi të jenë miratuar nga ana e KPM-së.*

7. Gjithashtu, neni 16 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 2 thekson se: *“Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor”.*
8. Në bazë të vlerësimit të rezultateve të DMF-së, Komisioni konstaton se, ndryshimi i lokacionit të transmetimit sipas kërkesës së Radio Maria, është i pranueshëm për arsye se dallimet në mes të pikës së tanishme (me lartësi mbidatë prej 596 m) dhe asajë të propozuar për vendosjen e transmetuesit (me lartësi mbidatë prej 531 m) janë të vogla dhe nuk do të ketë ndryshime të theksueshme në zonën e mbulimit, ndërsa, antenat duhet të jenë të orientuara në drejtim të qendrës së Obiliqit në 285°.
9. Në pajtim me nenin 16, paragrafi 1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Komisioni konstaton se kërkesa për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Maria është e bazuar dhe në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Licencës KPM-së, dhe si e tillë rekomandohet për miratim nga ana e Komisionit.

#### Vendim

10. Komisioni, në takimin e mbajtur më datën 22 nëntor 2017, merr vendim për lejimin e ndryshimit të lokacionit të transmetuesit, sipas kërkesës së Radio Maria, për të transmetuar nga pika e propozuar në fshatin Shkabaj.
11. Obligohet Radio Maria që t'i orientojë antenat në drejtim të qendrës së qytetit të Obiliqit, në kënd prej 285° (shkallëve), me qëllim të ruajtjes së mbulueshmërisë, sipas Kushteve dhe Termeve të Licencës së KPM-së.

#### Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Adnan MEROVCI

Kryetar  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



24.11.2017  
datë